

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
14	Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet për garantimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.	Progres i Moderuar	KQZ si edhe në zgjedhjet të mëparshme, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore angazhohet për të krijuar kushte në qendrat e votimit që do të bëjnë të mundur aksesueshmërine për të votuar për personat me aftësi të kufizura dhe vështirësi në lëvizje. Është i nevojshëm organizimi i procesit të monitorimit dhe vëzhgimit të përgatitjeve për plotësimin e kësaj kërkesë nga organizata të interesuara përpara ditës së zgjedhjeve. Monitorimi i listës së zgjedhësve me aftësi ndryshe që hartohet nga Komisioni i qendrës së votimit është proces që duhet të shoqërojë realizimin e këtij rekomandimi të Misionit të vëzhguesve ndërkombëtarë të OSBE/ODIHR.